

Kodi i Sjelljes dhe i Punës

Standardet minimale për të punuar së bashku me dinjitet, ndershmëri dhe kujdes.

Shënim mbi statusin ADCN (Diaspor Shqipëtare - Rrjeti Qytetar) është një rrjet qytetar i udhëhequr nga vullnetarë, jo një organizatë e regjistruar, person juridik më vete ose parti politike. Referencat ndaj “ADCN” në këtë dokument përshkruajnë rregullat dhe praktikën e përbashkëta të rrjetit.

KODI I SJELLJES

- Trajtoji njerëzit me dinjitet dhe mirësjellje, edhe kur nuk pajtoheni me mendimin e tyre.
- Kritiko idetë, informacionin dhe sjelljen pa poshtëruar apo sulmuar personin.
- Respekto kohën, kufijtë, ekspertizën dhe kapacitetin vullnetar të të tjerëve.
- Jep kredit të saktë autorëve, studiuesve, dizajnerëve, përkthyesve, fotografëve dhe kontribuesve.
- Mbro diskutimet konfidenciale, materialet në draft dhe informacionin personal.
- Përdor dokumentet, llogaritë dhe hapësirat e përbashkëta vetëm për qëllimin për të cilin janë krijuar.



ÇFARË NUK PRANOHET

- Bullizmi, ngacmimi, përndjekja, kërcënimet, frikësimi.
- Diskriminimi ose trajtimi poshtëruar për shkak të një karakteristike personale.
- Publikimi keqdashës i të dhënave personale (“doxxing”), imitimi i identitetit, shpërndarja keqdashëse e informacionit privat ose ekspozimi i qëllimshëm i një pjesëmarrësi ndaj rrezikut.
- Deklarata të rreme, prova të fabrikuara, plagjiaturë ose atribim i qëllimshëm i gabuar.
- Përfaqësimi i paautorizuar i ADCN, keqpërdorimi i logos ose publikimi pa leje i dokumenteve konfidenciale.
- Sjellja armiqësore e përsëritur që e bën pjesëmarrjen të pasigurt ose të paarsyeshme.

MOSMARRËVESHJET DHE KONFLIKTET

ADCN e konsideron normale mospajtimin pasi ne synojmë të krijojmë një hapësirë demokratike ku secili/a është i/e lirë të shprehë mendimin e tij/saj. Kur është e sigurt dhe e përshtatshme, shqetësimet mund të adresohen fillimisht drejtpërdrejt dhe me respekt. Nëse kjo nuk është e përshtatshme ose nuk funksionon, mund të ndihmojë një koordinator ose person pa konflikt interesi. Askush nuk detyrohet të përballet drejtpërdrejt me një person kur ka pabarazi pushteti, çështje sigurie ose pretendim serioz.

KONFIDENCIALITETI DHE ATRIBUIMI

Diskutimet e brendshme nuk janë automatikisht publike. Kontribuesit duhet të kontrollojnë statusin e dokumenteve në draft dhe grupeve private para shpërndarjes. Konfidencialiteti nuk përdoret për të fshehur shkelje: shqetësimet e mbrojtura mund të raportohen përmes rrugës së përcaktuar. Puna duhet të kreditohet në përpjesëtim me kontributin. Redaktimi, koordinimi ose publikimi nuk justifikon heqjen e kontributit të autorit apo ekspertit fillestar.

AKSESI DHE PASOJAT

Responses should be proportionate and may include a reminder, mediation, restricted access, reassignment, formal warning, removal from a role or ending participation. Serious safety, harassment, data-protection or integrity concerns may justify immediate temporary restrictions while the matter is reviewed.

NGRITJA/ RAPORTIMI I NJË SHQETËSIMI

Shqetësimet mund t’i drejtohen një koordinatori ose rrugës së përcaktuar për raportim. Nëse shqetësimi lidhet me kontaktin e zakonshëm, ai duhet t’i dërgohet një koordinatori tjetër pa konflikt interesi ose në **team@albaniandiasporacivicnetwork.com**. Sulmi dhe sjellja në kundërshti me kodin e sjelljes ndaj një personi që ngre një shqetësim me mirëbesim është e ndaluar.

Kjo rregullore është një standard i qeverisjes së ADCN Ajo nuk krijon personalitet juridik të veçantë për rrjetin dhe nuk zëvendëson detyrimet që rrjedhin nga ligji i zbatueshëm